

AKT THEMELIMI
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

A.M.E MEDIA SOLUTIONS

Sot, më datë 24.02.2025, personalisht:

Anxhela Balla, atesia Çlirim, shtetase shqiptare, lindur ne Lushnje dhe baunuese ne Durres, Lagjia 13, Rruga Lule Bore, Plazh, lindur me 20.03.1998, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me karte identiteti me Nr. J85320025G me cilesine e ortakut themelues te shoqerise tregtare **A.M.E Media Solutions**.

Përpilon këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare me termat e mëposhtme:

NENI 1

Të themelojë Shoqërinë Tregtare në formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar. Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me:

Emri i Shoqerise: **A.M.E Media Solutions shpk**

Emri tregtar: **A.M.E Media Solutions**

NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3 Objekti i veprimtarisë

Shoqëria, në përputhje me dispozitat dhe kufizimet e ligjit, ka për objekt veprimtaritë e mëposhtme:

Marketing, zhvillim, ndërtim dhe mirëmbajtje website. Përpunimi i të dhënave, aktivitete mbajtëse (hosting) të informacionit dhe aktivitete të lidhura me to, portat web.

NENI 4 Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Lagjia 14, Rruga Kavaja, Banesa Nr,4, Durres.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 5 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar eshte 100.000 (njqind mije) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.



Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

NENI 6

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Anxhela Balla, pjesemarrja me perqindje 100 %, 1 kuote, lloji i kontributit ne para 100.000 leke.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

NENI 7 Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/et – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8 Administratori

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administatori i parë te shoqërisë do të jenë Zj.Anxhela Balla

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 9

Oratku mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 11

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.



NENI 12

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe pasi ortaku është njohës i gjuhës shqipe.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

ANXHELA BALLA

Anxhela Balla
